

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Transformimi dhe konsolidimi I infrastruktures Dixhitale dhe Data center te UKT sh.a

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV) Direct-access storage devices (dasd) 30233140-4

Switch blades 34946221-5

Paketa software per switche ose routera 482195000-1

Servera rrjeti 48821000-9

Servera kompjuterike 4882000-6

VLERA E FONDIT LIMIT: 139.555.130 (njqind e tridhjte e nente milion e pesqind e pesedhjte e pese mije e njqind e tridhjte) lekë pa tvsh.

Vlera e fondit Limit ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 1.488.905,68 (një milion e katerqind e tetedhjte e tete mije e nenteqind e pese presje gjashtedhjte e tete) euro .

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 14.07.2026 është 93.73 Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2.791.102,6 (dy milion e shtateqind e nentedhjte ee nje mije e njqind e dy presje gjashte) lekë.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës në monedhën ndërkombetare Euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 29.778,11 (njetet e nente mije e shtateqind e shtatedhjetë e tete presje njembëdhjetë) euro.

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 14.07.2026 është 93.73 euro.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”e ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 43, pika 1, pika 2 b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne nenin 43 , pika 1 , pika 2 , si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023,2024,2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori

ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar.

Nëse kërkohen balance të tri viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenit 19, pika 2, të VKM Nr. 498, datë 1.8.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, të ndryshuar.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006.“Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitet e vetëqeverisjes vendore për vitin 2026).**

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2026 sipas kështesave pranë bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e shërbimeve të ofruara, ose,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e shërbimeve të ofruara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

- c) Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (**ekuivalente**) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

- b) Çertifikatën për sigurinë e informacionit **ISO 27001:2022 (ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre përsiper sipas akt-marreveshjes).

Çertifikatën për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit **ISO 20000-1:2018** ose **(ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

Certifikimi **ISO 9001:2015** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësive implementuese.

Certifikimi **ISO 27001:2022** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe e kanë një rëndësi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikepamja informatike dhe të jenë të kontrolluara dhe si dhe aksesimi mbi to të jetë i verifikueshëm e i kodifikuar). Kjo vjen pasi në këtë kontratë do të kryesojë vijimi i mirëmbajtjes dhe upgrade të sistemeve ekzistuese që kërkojnë kompetencë të shtuar profesionale në këtë drejtim, pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorinë e mbrojtjes kibernetike.

Certifikimi **ISO 20000-1:2018** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qenë se zoteron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjisë së informacionit, duke pasur me shumë garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të gjithë sistemin në teresi i cili është teresisht i bazuar në produkte TIK (software dhe hardware), pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorinë e mbrojtjes kibernetike.

2.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose nga një Distributor i Autorizuar, përmes të cilit konfirmohet se operatori ekonomik është i autorizuar për tregtimin e të gjitha produkteve hardware dhe software të përfshira në objektin e këtij prokurimi.

Në rast se paraqitet autorizim i lëshuar nga një Distributor i Autorizuar, duhet të evidentohet dhe verifikohet qartë marrëdhënia zyrtare ndërmjet Prodhuesit dhe Distributorit Rajonal të Autorizuar, në mënyrë që të garantohet vlefshmëria dhe autenticiteti i autorizimit të paraqitur.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Autorizimi i prodhuesit përbën një dokument thelbësor, pasi përveçse dëshmon kanalin zyrtar të origjinës së produkteve apo licencave të kërkuara në procedurë, garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin e tyre pranë Autoritetit Kontraktor. Kjo garanci lidhet drejtpërdrejt me cilësinë e produkteve/shërbimeve të kërkuara, të cilat duhet të jenë të prodhuara ose të zhvilluara sipas standardeve më të larta nga prodhues me reputacion ndërkombëtar dhe të njohur në praktikat e tyre tregtare.

Ky kriter nuk është diskriminues, por është në përpjesëtim me natyrën dhe objektin e kontratës, duke u lidhur ngushtësisht me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik në aspektin e kapaciteteve teknike dhe profesionale. Kërkesa i shërben Autoritetit Kontraktor për të verifikuar kapacitetet tekniko-profesionale të operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se ai disponon autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve, shërbimeve apo licencave objekt kontrate, të lëshuara nga prodhuesit ose distributorët zyrtarë.

Në këtë mënyrë sigurohet jo vetëm ligjshmëria e zinxhirit të furnizimit, por edhe vazhdimësia dhe qëndrueshmëria e shërbimit gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, përmes bashkëpunimit me të njëjtët prodhues apo struktura të autorizuar të tyre.

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.6 Operatori pjesëmarrës për të vërtetuar që ka kapacitete njerezore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas termave të referencës të projektit, duhet të vërtetojë se ka jo më pak se 8 (tete) Inxhinierë/Specialistë të diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike / Inxhinieri Informatike / Teknologji Informatike / Informatike / Informatike Matematike / Inxhinieri Matematike dhe Informatike, Informatike Ekonomike / Telekomunikacion / Inxhinieri Telekomunikacion që do të angazhohen në implementimin e projektit, ku të vërtetohen nepermjet diplomes dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit (duke marrë si referencë datën e hapjes së ofertave), nga të cilët:

- a) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar si Menaxher Projekti, PMP ose ekuivalent;

- b) Te pakten 1 (një) specialist te certifikuar per menaxhimin e sherbimeve IT, ITIL ose ekuivalent;
- c) Te pakten 2 (dy) specialiste te certifikuar ne nivel profesional nga prodhuesi per infrastrukturen hiperkonvergjente HCI te ofertuar ose ekuivalent;
- d) Te pakten 2 (dy) specialiste te certifikuar ne nivel profesional nga prodhuesi per pajisje e krijimit të kopjes rezervë nga disku në disk te ofertuar ose ekuivalent;
- e) Te pakten 2 (dy) specialiste te certifikuar ne nivel profesional nga prodhuesi ose ekuivalent per servera;
- f) Te pakten 2 (dy) specialiste te certifikuar nga prodhuesi per software per backup te ofertuar ose ekuivalent;
- g) Te pakten 2 (dy) specialiste te certifikuar nga prodhuesi per pajisje firewall te ofertuar ose ekuivalent;
- h) Te pakten 2 (dy) specialiste te certifikuar nga prodhuesi ne nivel profesional per rrjetat CCNP ose ekuivalent;
- i) Te pakten 1 (një) specialist te certifikuar CIR “Certified Incident Responder” ose ekuivalente;
- j) Te pakten 2 (dy) specialist te certifikuar “Cyber Threat Hunting Professional” ose ekuivalente;

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, per te gjithë punonjesit e mesiperm pjese e stafit te punesuar nga vete OE, duhet te paraqiten certifikatat perkatese te kualifikimit si dhe operatori ekonomik duhet te vertetoje se i ka te punesuar per muajin e fundit (duke marre si reference data e hapjes se ofertave).

Një punonjës mund të disponojë një ose më shumë se një certifikim.

Për të vërtetuar disponimin e stafit te mësipërm operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikatat perkatese te kualifikimit per secilin nga specialistet e mesiperm.
- Listepagesat e punonjesve dorezuara nepermjet formes elektronike ne organet kompetente sipas legjislacionit në fuqi, per muajin e fundit (duke marre si reference data e hapjes se ofertave).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 5 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

Argumentim per kriterin ne piken a): Kërkesa për të paktën 1 (një) specialist të certifikuar si Menaxher Projekti, PMP (Project Management Professional) ose ekuivalent është e nevojshme dhe proporcionale me objektin e kontratës, e cila përfshin furnizimin, instalimin, konfigurimin dhe integrimin e një infrastrukture komplekse IT në disa komponentë dhe lokacione. Zbatimi i kontratës kërkon planifikim, koordinim dhe monitorim të vazhdueshëm të aktiviteteve, menaxhim të burimeve, afateve, risqeve dhe komunikimit ndërmjet palëve të përfshira, me qëllim realizimin e projektit sipas kërkesave teknike dhe brenda afateve kontraktore. Certifikimi PMP ose ekuivalent garanton që specialisti disponon njohuritë dhe aftësitë profesionale për menaxhimin e projekteve sipas standardeve të njohura ndërkombëtare, duke kontribuar në organizimin efektiv të punimeve, koordinimin e ekipeve teknike dhe minimizimin e risqeve gjatë zbatimit të kontratës.

Kriteri është në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, pasi lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës, është proporcional me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën, duke lejuar edhe certifikime ekuivalente.;

Argumentim per kriterin ne piken b): Kërkesa për të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT, ITIL ose ekuivalent është e nevojshme dhe proporcionale me objektin e kontratës, e cila përfshin implementimin dhe mbështetjen e një infrastrukture kritike IT. Zbatimi i kontratës kërkon që shërbimet e ofruara të organizohen dhe menaxhohen sipas praktikave më të mira për administrimin e shërbimeve IT, duke garantuar menaxhimin e incidenteve, ndryshimeve, konfigurimeve, disponueshmërisë dhe vazhdimësisë së shërbimit. Certifikimi ITIL ose ekuivalent garanton se specialisti disponon njohuritë e nevojshme për organizimin dhe menaxhimin e proceseve të shërbimeve IT sipas standardeve të njohura ndërkombëtare. Prania e një specialisti të tillë kontribuon në koordinimin e aktiviteteve të implementimit, tranzicionit në operim dhe mbështetjes teknike, duke siguruar cilësi, vazhdimësi dhe minimizim të ndërprerjeve të shërbimeve.

Kriteri është në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, pasi lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës, është proporcional me natyrën dhe kompleksitetin e saj dhe nuk kufizon konkurrencën, duke lejuar edhe certifikime ekuivalente.

Argumentim per kriterin ne piken c): Kërkesa për të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për infrastrukturën hiperkonvergjente (HCI) të ofertuar ose ekuivalent është e nevojshme dhe proporcionale me objektin e kontratës, e cila përfshin furnizimin, instalimin, konfigurimin, integrimin dhe vënien në funksion të një infrastrukture HCI, si komponenti kryesor i qendrës së të dhënave të Autoritetit Kontraktor. Infrastruktura HCI është një platformë e avancuar që integron në një sistem të vetëm burimet e përpunimit (compute), ruajtjes së të dhënave (storage), virtualizimit dhe menaxhimit të centralizuar. Implementimi i saj kërkon njohuri të specializuara për konfigurimin e njeve (nodes), krijimin dhe administrimin e cluster-it, konfigurimin e storage-it të shpërndarë, integrimin me infrastrukturën e rrjetit, sistemin e backup-it dhe komponentët e sigurisë, si dhe testimin e funksionalitetit dhe performancës së platformës. Certifikimi profesional nga prodhuesi ose ekuivalent garanton se specialistët disponojnë njohuritë dhe aftësitë teknike të nevojshme për implementimin e platformës në përputhje me standardet dhe praktikatat më të mira të rekomanduara nga prodhuesi, duke minimizuar rrezikun e konfigurimeve të gabuara që mund të ndikojnë në disponueshmërinë, performancën dhe besueshmërinë e infrastrukturës. Kërkesa për të paktën 2 (dy) specialistë justifikohet nga kompleksiteti i implementimit të infrastrukturës HCI dhe nevoja për të garantuar kapacitete të mjaftueshme profesionale gjatë fazave të instalimit, konfigurimit, migrimit, testimit dhe vënies në punë të sistemit. Gjithashtu, kjo kërkesë siguron vazhdimësinë e punimeve dhe redukton riskun operacional që mund të krijohet nga varësia ndaj një individi të vetëm, duke garantuar realizimin e kontratës brenda afateve dhe sipas kërkesave teknike të përcaktuara.

Nga pikëpamja ligjore, kjo kërkesë mbështetet në nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit autoritetet kontraktore mund të vendosin kritere që garantojnë se operatorët ekonomikë disponojnë burimet e nevojshme njerëzore dhe profesionale për realizimin e kontratës sipas standardeve të kërkuara të cilësisë. Po ky nen përcakton se kërkesat e kualifikimit duhet të

jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës. Kërkesa nuk është diskriminuese, pasi nuk kufizohet vetëm në certifikime të një marke të caktuar, por lejon edhe certifikime ekuivalente profesionale, duke garantuar konkurrencën dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, ndërkohë që siguron nivelin minimal të ekspertizës së nevojshme për implementimin e suksesshëm.

Argumentim per kriterin ne piken d): Kërkesa për të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjet e krijimit të kopjeve rezervë nga disku në disk (Disk-to-Disk Backup Appliance) të ofertuara ose ekuivalent është e nevojshme dhe proporcionale me objektin e kontratës, e cila përfshin furnizimin, instalimin, konfigurimin dhe integrimin e zgjidhjes së backup-it si pjesë e infrastrukturës së re IT. Pajisjet e backup-it disk-to-disk përbëjnë një komponent kritik për mbrojtjen e të dhënave, duke garantuar ruajtjen e kopjeve rezervë, rikuperimin e shpejtë të informacionit dhe vazhdimësinë e shërbimeve në rast incidentesh, defektesh teknike apo sulmesh kibernetike. Implementimi i tyre kërkon njohuri të specializuara për konfigurimin e politikave të backup-it, deduplikimit dhe kompresimit të të dhënave, integrimin me platformën HCI, software-in e backup-it dhe infrastrukturën e rrjetit, si dhe testimin e procedurave të rikuperimit. Certifikimi profesional nga prodhuesi ose ekuivalent garanton se specialistët disponojnë kompetencat teknike të nevojshme për instalimin, konfigurimin dhe administrimin e pajisjeve sipas standardeve dhe praktikave më të mira të rekomanduara nga prodhuesi, duke minimizuar rrezikun e konfigurimeve të gabuara që mund të cenojnë sigurinë dhe disponueshmërinë e të dhënave. Kërkesa për 2 (dy) specialistë justifikohet nga nevoja për të garantuar kapacitete të mjaftueshme profesionale gjatë fazave të implementimit, konfigurimit, testimit dhe vënies në funksion të zgjidhjes së backup-it, si dhe për të siguruar vazhdimësinë e punimeve dhe reduktimin e riskut operacional që mund të krijohet nga varësia ndaj një individi të vetëm..

Nga pikëpamja ligjore, kjo kërkesë mbështetet në nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit autoritetet kontraktore mund të vendosin kritere që garantojnë se operatorët ekonomikë disponojnë burimet e nevojshme njerëzore dhe profesionale për realizimin e kontratës sipas standardeve të kërkuara të cilësisë. Po ky nen përcakton se kërkesat e kualifikimit duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës. Kërkesa nuk është diskriminuese, pasi nuk kufizohet vetëm në certifikime të një marke të caktuar, por lejon edhe certifikime ekuivalente profesionale, duke garantuar konkurrencën dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, ndërkohë që siguron nivelin minimal të ekspertizës së nevojshme për implementimin e suksesshëm.

Argumentim per kriterin ne piken e): Kërkesa për të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi i serverëve ose ekuivalent është e nevojshme dhe proporcionale me objektin e kontratës, e cila përfshin furnizimin, instalimin, konfigurimin dhe integrimin e serverëve si pjesë e infrastrukturës së re IT dhe platformës HCI. Serverët përbëjnë bazën fizike të infrastrukturës kompjuterike dhe janë komponent kritik për funksionimin e mjedisit virtualizues dhe shërbimeve të biznesit. Implementimi i tyre kërkon njohuri të specializuara për instalimin fizik në rack, konfigurimin e BIOS/firmware, RAID, integrimin me cluster-in HCI, konfigurimin e virtualizimit, si dhe testimin e performancës dhe stabilitetit të sistemit. Certifikimi profesional nga prodhuesi ose ekuivalent garanton që specialistët zotërojnë njohuritë teknike të nevojshme për implementimin sipas standardeve të prodhuesit, duke minimizuar rrezikun e gabimeve në konfigurim që mund të ndikojnë në performancën, stabilitetin dhe disponueshmërinë e sistemit. Kërkesa për 2 (dy) specialistë justifikohet nga nevoja për kapacitete të mjaftueshme profesionale gjatë fazave të instalimit,

konfigurimit, integritit dhe testimit, si dhe për të siguruar vazhdimësi operationale dhe reduktim të riskut nga varësia ndaj një individi të vetëm gjatë zbatimit të kontratës.

Nga pikëpamja ligjore, kjo kërkesë mbështetet në nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit autoritetet kontraktore mund të vendosin kritere që garantojnë se operatorët ekonomikë disponojnë burimet e nevojshme njerëzore dhe profesionale për realizimin e kontratës sipas standardeve të kërkuara të cilësisë. Po ky nen përcakton se kërkesat e kualifikimit duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës. Kërkesa nuk është diskriminuese, pasi nuk kufizohet vetëm në certifikime të një marke të caktuar, por lejon edhe certifikime ekuivalente profesionale, duke garantuar konkurrencën dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, ndërkohë që siguron nivelin minimal të ekspertizës së nevojshme për implementimin e suksesshëm.

Argumentim per kriterin ne piken f): Kërkesa për disponimin e të paktën 2 (dy) specialistëve të certifikuar nga prodhuesi i software-it të backup-it të ofertuar ose ekuivalent është e nevojshme dhe proporcionale me objektin e kontratës, duke pasur parasysh rëndësinë kritike që ka sistemi i backup-it në garantimin e integritetit, disponueshmërisë dhe rikuperimit të të dhënave të institucionit. Zgjidhja e backup-it përbën një komponent thelbësor të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, pasi siguron mbrojtjen e të dhënave kundër humbjes aksidentale, defekteve teknike, sulmeve kibernetike, incidenteve të sigurisë dhe situatave të fatkeqësive. Implementimi i një platforme moderne backup-i kërkon njohuri të specializuara për instalimin, konfigurimin, integritetin, përcaktimin e politikave të backup-it dhe retention-it, konfigurimin e mekanizmave të rikuperimit (restore), monitorimin e proceseve, si dhe testimin periodik të procedurave të rikthimit të të dhënave. Certifikimi profesional nga prodhuesi ose ekuivalent vërteton se specialistët zotërojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të implementuar dhe administruar zgjidhjen sipas praktikave dhe standardeve të rekomanduara nga prodhuesi, duke minimizuar rrezikun e konfigurimeve të gabuara që mund të cenojnë sigurinë dhe rikuperueshmërinë e të dhënave.

Nga pikëpamja ligjore, kjo kërkesë mbështetet në nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit autoritetet kontraktore mund të vendosin kritere që garantojnë se operatorët ekonomikë disponojnë burimet e nevojshme njerëzore dhe profesionale për realizimin e kontratës sipas standardeve të kërkuara të cilësisë. Po ky nen përcakton se kërkesat e kualifikimit duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës. Kërkesa nuk është diskriminuese, pasi nuk kufizohet vetëm në certifikime të një marke të caktuar, por lejon edhe certifikime ekuivalente profesionale, duke garantuar konkurrencën dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, ndërkohë që siguron nivelin minimal të ekspertizës së nevojshme për implementimin e suksesshëm.

Argumentim per kriterin ne piken g): Kërkesa për të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve firewall të ofertuara ose ekuivalent është e domosdoshme dhe proporcionale me objektin e kontratës, e cila përfshin furnizimin, instalimin dhe konfigurimin e 17 pajisjeve firewall (2 në HQ dhe 15 në degë). Këto pajisje përbëjnë komponentin kryesor të sigurisë së rrjetit dhe kërkojnë ekspertizë të specializuar për konfigurimin e politikave të sigurisë, VPN-ve, segmentimit të rrjetit dhe integritetit ndërmjet lokacioneve. Kompleksiteti i implementimit në disa pika gjeografike rrit nevojën për

kapacitete të mjaftueshme profesionale dhe koordinim teknik gjatë fazave të instalimit dhe testimit. Certifikimi nga prodhuesi ose ekuivalent garanton njohuri të standardizuara për konfigurim dhe menaxhim të pajisjeve sipas praktikave të rekomanduara, duke minimizuar riskun e gabimeve që mund të cenojnë sigurinë e sistemit. Duke qenë se pajisjet firewall do të implementohen në 16 lokacione të ndryshme (HQ dhe 15 degë) dhe do të krijojnë një arkitekturë të unifikuar sigurie me politika të centralizuara, kërkesa për 2 specialistë të certifikuar përfaqëson një kërkesë minimale dhe të arsyeshme, e cila synon garantimin e sigurisë, cilësisë së implementimit dhe respektimit të afateve të kontratës.

Nga pikëpamja ligjore, kjo kërkesë mbështetet në nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit autoritetet kontraktore mund të vendosin kritere që garantojnë se operatorët ekonomikë disponojnë burimet e nevojshme njerëzore dhe profesionale për realizimin e kontratës sipas standardeve të kërkuara të cilësisë. Po ky nen përcakton se kërkesat e kualifikimit duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës. Kërkesa nuk është diskriminuese, pasi nuk kufizohet vetëm në certifikime të një marke të caktuar, por lejon edhe certifikime ekuivalente profesionale, duke garantuar konkurrencën dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, ndërkohë që siguron nivelin minimal të ekspertizës së nevojshme për implementimin e suksesshëm.

Argumentim për kriterin në piken h): Në kuadër të implementimit të një infrastrukture komplekse IT si dhe sistemet përkatëse të sigurisë dhe lidhshmërisë, kërkohet domosdoshmërisht përfshirja e personelit teknik me nivel të lartë ekspertize në rrjetëzim dhe siguri. Certifikimi në nivel profesional si CCNP ose ekuivalent garanton që specialistët kanë njohuri të avancuara në projektimin, implementimin dhe troubleshooting të rrjeteve komplekse enterprise, përfshirë routing & switching, sigurinë e rrjetit, optimizimin e performancës dhe integrimin e teknologjive WAN moderne si SD-WAN.

Duke qenë se projekti përfshin:

- ndërlidhje të 15 degëve në një arkitekturë të centralizuar dhe të sigurt,
- implementim firewall-esh qendrore dhe të shpërndara,
- integrim të infrastrukturës HCI me rrjetin ekzistues,
- zgjidhje backup dhe replikimi që varen nga stabiliteti i rrjetit,
- kërkesa për disponueshmëri të lartë (high availability) dhe vazhdimësi shërbimi,

është e domosdoshme që konfigurimi, optimizimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të kryhet nga specialistë të certifikuar, të cilët ndjekin praktikën më të mirë të industrisë dhe standardet e prodhuesve.

Për më tepër, prania e të paktën dy specialistëve të tillë siguron:

- reduktim të rrezikut operativ dhe gabimeve në konfigurim,
- aftësi për reagim të shpejtë në incidente kritike,
- vazhdimësi të shërbimit edhe në rast mungese të një eksperti,
- aftësi për implementim paralel të komponentëve të ndryshëm të projektit,
- garantim të përputhshmërisë ndërmjet pajisjeve dhe platformave të ndryshme.

Në këtë kontekst, kërkesa për certifikim CCNP ose ekuivalent nuk është kufizuese, por përfaqëson një standard minimal të domosdoshëm profesional për të garantuar suksesin, sigurinë dhe qëndrueshmërinë e projektit në një mjedis enterprise me kompleksitet të lartë..

Nga pikëpamja ligjore, kjo kërkesë mbështetet në nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit autoritetet kontraktore mund të vendosin kritere që garantojnë se operatorët ekonomikë disponojnë burimet e nevojshme njerëzore dhe profesionale për realizimin e kontratës sipas standardeve të kërkuara të cilësisë. Po ky nen përcakton se kërkesat e kualifikimit duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës. Kërkesa nuk është diskriminuese, pasi nuk kufizohet vetëm në certifikime të një marke të caktuar, por lejon edhe certifikime ekuivalente profesionale, duke garantuar konkurrencën dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, ndërkohë që siguron nivelin minimal të ekspertizës së nevojshme për implementimin e suksesshëm.

Argumentim per kriterin ne piken i): Kërkesa për të paktën 1 (një) specialist të certifikuar CIR “Certified Incident Responder” ose ekuivalent është e domosdoshme dhe proporcionale me objektin e kontratës, duke marrë në konsideratë nevojën për kapacitete profesionale në menaxhimin e incidenteve të sigurisë kibernetike gjatë implementimit dhe operimit të infrastrukturës IT të ofruar. Infrastruktura që implementohet (HCI, firewall, backup dhe rrjet enterprise) rrit ekspozimin ndaj rreziqeve kibernetike dhe incidenteve të sigurisë, të cilat mund të ndikojnë në disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemeve dhe të dhënave. Për këtë arsye, është e nevojshme disponimi i një specialisti të kualifikuar në identifikimin, analizimin, menaxhimin dhe reagimin ndaj incidenteve të sigurisë. Certifikimi CIR ose ekuivalent vërteton aftësi profesionale në trajtimin e incidenteve, izolimin e kërcënimeve, analizën forenzike bazë dhe rikuperimin e sistemeve, duke minimizuar ndikimin operacional dhe duke siguruar vazhdimësinë e shërbimeve kritike. Kërkesa për të paktën një specialist është e justifikuar për të garantuar një pikë të dedikuar përgjegjësie për menaxhimin e incidenteve të sigurisë, veçanërisht gjatë fazës së implementimit dhe periudhës së stabilizimit të sistemit, kur rreziku i incidenteve është më i lartë.

Nga pikëpamja ligjore, kjo kërkesë mbështetet në nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit autoritetet kontraktore mund të vendosin kritere që garantojnë se operatorët ekonomikë disponojnë burimet e nevojshme njerëzore dhe profesionale për realizimin e kontratës sipas standardeve të kërkuara të cilësisë. Po ky nen përcakton se kërkesat e kualifikimit duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës. Kërkesa nuk është diskriminuese, pasi nuk kufizohet vetëm në certifikime të një marke të caktuar, por lejon edhe certifikime ekuivalente profesionale, duke garantuar konkurrencën dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, ndërkohë që siguron nivelin minimal të ekspertizës së nevojshme për implementimin e suksesshëm.

Argumentim per kriterin ne piken j): Kërkesa për të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar “Cyber Threat Hunting Professional” ose ekuivalent është e domosdoshme dhe proporcionale me objektin e kontratës, duke marrë në konsideratë nevojën për kapacitete të avancuara në identifikimin proaktiv të kërcënimeve kibernetike në infrastrukturën që do të implementohet. Duke qenë se projekti përfshin implementimin e një infrastrukture komplekse (HCI, firewall, backup dhe rrjet enterprise), rritet ndjeshëm sipërfaqja e ekspozimit ndaj sulmeve

kibernetike dhe nevoja për monitorim të vazhdueshëm të aktiviteteve të dyshimta në rrjet dhe sisteme. Specialistët e certifikuar në “Cyber Threat Hunting” kanë aftësitë e nevojshme për të kryer analizë proaktive të log-eve, identifikim të anomalive, zbulim të kërcënimeve të avancuara (APT), si dhe për të reaguar në mënyrë të hershme përpara se incidentet të eskalojnë në ndërprerje shërbimesh ose komprometim të të dhënave. Kërkesa për 2 specialistë justifikohet nga nevoja për mbulim të vazhdueshëm dhe paralel të aktiviteteve të monitorimit dhe analizës së sigurisë, duke reduktuar varësinë nga një individ i vetëm dhe duke rritur efektivitetin e detektimit të kërcënimeve në kohë reale.

Nga pikëpamja ligjore, kjo kërkesë mbështetet në nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit autoritetet kontraktore mund të vendosin kritere që garantojnë se operatorët ekonomikë disponojnë burimet e nevojshme njerëzore dhe profesionale për realizimin e kontratës sipas standardeve të kërkuara të cilësisë. Po ky nen përcakton se kërkesat e kualifikimit duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës. Kërkesa nuk është diskriminuese, pasi nuk kufizohet vetëm në certifikime të një marke të caktuar, por lejon edhe certifikime ekuivalente profesionale, duke garantuar konkurrencën dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, ndërkohë që siguron nivelin minimal të ekspertizës së nevojshme për implementimin e suksesshëm.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësura me origjinalin.”.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë ,markë,emër i veçantë ,patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim për kapitullin 1 – INFRASTRUKTURA HIPERKONVERGJENTE (HCI)

Specifikimet teknike për Infrastrukturën Hiperkonvergjente janë hartuar në funksion të krijimit të një platforme moderne, të centralizuar dhe të shkallëzueshme për përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave të Autoritetit Kontraktor. Infrastruktura HCI përbën komponentin kryesor të Data Center-it të ri dhe do të mbështesë funksionimin e sistemeve kritike të informacionit të UKT sh.a., duke

integruar në një platformë të vetme burimet e procesimit (CPU), memories (RAM), ruajtjes së të dhënave (Storage), virtualizimit dhe administrimit të centralizuar.

Kërkesat për arkitekturën x86, numrin minimal të procesorëve, memories dhe kapacitetit SSD janë përcaktuar mbi bazën e nevojave aktuale të Autoritetit Kontraktor dhe zhvillimit të pritshëm të sistemeve të informacionit gjatë viteve në vijim, duke garantuar kapacitete të mjaftueshme për zgjerim pa ndërprerje të shërbimeve.

Kërkesat për High Availability (HA), Distributed Storage, Data Protection, Self-Healing, Load Balancing, Deduplication, Compression, Erasure Coding, Scale-Out Architecture, REST API, monitorim të centralizuar dhe automatizim janë të domosdoshme për të garantuar disponueshmërinë e vazhdueshme të sistemeve, eliminimin e pikave të vetme të dështimit (Single Point of Failure), rritjen e performancës dhe optimizimin e administrimit të infrastrukturës.

Po kështu, kërkesat për mbështetjen e më shumë se një prodhuesi serverash dhe të hipervizorëve VMware ESXi, Microsoft Hyper-V dhe AHV janë vendosur për të shmangur varësinë teknologjike ndaj një prodhuesi të vetëm (Vendor Lock-in), duke garantuar konkurrencën dhe mbrojtjen e investimit të Autoritetit Kontraktor.

Specifikimet janë përcaktuar mbi bazën e performancave minimale dhe nuk favorizojnë asnjë prodhues të veçantë.

Argumentim për kapitullin 2 – PAJISJA E KRIJIMIT TË KOPJES REZERVË NGA DISKU NË DISK (BACKUP APPLIANCE)

Specifikimet teknike për pajisjen Disk-to-Disk Backup Appliance janë hartuar për të garantuar mbrojtjen e të dhënave, vazhdimësinë e biznesit (Business Continuity) dhe rikuperimin në rast fatkeqësish (Disaster Recovery).

Pajisja e backup-it përbën komponent kritik të arkitekturës së Data Center-it, pasi siguron ruajtjen e kopjeve rezervë, rikuperimin e shpejtë të sistemeve dhe mbrojtjen kundër humbjes së të dhënave si pasojë e defekteve teknike, gabimeve njerëzore ose sulmeve kibernetike.

Kërkesat për deduplikim, kompresim, RAID 6, enkriptim, replikim HQ-DR, deduplikim global, cloud tier, retention lock, Instant Recovery, integrim me aplikacionet enterprise dhe performancën minimale janë vendosur për të garantuar një sistem backup-i me disponueshmëri të lartë, konsum optimal të hapësirës së ruajtjes dhe kohë minimale rikuperimi.

Këto kërkesa lidhen drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe janë proporcionale me rëndësinë e sistemeve të informacionit të Autoritetit Kontraktor.

Argumentim për kapitullin 3 – SOFTWARE PËR BACKUP

Specifikimet teknike për software-in e backup-it janë hartuar për të garantuar administrimin e centralizuar të proceseve të kopjeve rezervë, automatizimin e politikave të backup-it, monitorimin, raportimin dhe rikuperimin e të dhënave.

Kërkesat për integrim me HCI, Backup Appliance, virtualizimin, aplikacionet enterprise, deduplikimin, kompresimin, replikimin dhe Disaster Recovery janë të nevojshme për të krijuar një zgjidhje të unifikuar dhe të qëndrueshme të mbrojtjes së të dhënave.

Argumentim për kapitullin 4 – FIREWALL HQ DHE FIREWALL BRANCH

Specifikimet teknike për pajisjet Firewall janë hartuar për të garantuar mbrojtjen kibernetike të infrastrukturës së Autoritetit Kontraktor në përputhje me praktikat moderne të sigurisë së informacionit.

Projekti përfshin implementimin e një arkitekture të centralizuar sigurie me 2 firewall në Data Center dhe 15 firewall në degët e UKT sh.a., të cilat do të funksionojnë si një sistem i integruar.

Për këtë arsye janë kërkuar funksionalitete si:

- Application Awareness
- Intrusion Prevention System (IPS)
- Anti-Malware
- Anti-Spyware
- URL Filtering
- DNS Security
- Zero-Day Malware Protection
- Machine Learning
- Threat Prevention
- Sandboxing
- SSL Inspection
- SD-WAN
- Zero Trust
- MFA Integration
- IoT Security
- High Availability
- Centralized Management

Këto funksionalitete janë të domosdoshme për mbrojtjen e sistemeve kritike të Autoritetit Kontraktor nga kërcënimet moderne kibernetike dhe për garantimin e disponueshmërisë së vazhdueshme të shërbimeve.

Argumentim për kapitullin 5 – TOP OF RACK SWITCH

Specifikimet teknike për Top of Rack Switch janë hartuar për të siguruar ndërlidhjen me performancë të lartë ndërmjet serverëve, storage-it, firewall-eve dhe pajisjeve të tjera të Data Center-it.

Kërkesat për 25GbE, 100GbE, VXLAN EVPN, BGP, OSPF, VRF, Streaming Telemetry, NetFlow, ACL, DHCP Snooping, Dynamic ARP Inspection dhe Control Plane Policing janë vendosur për të garantuar një rrjet enterprise me disponueshmëri të lartë, performancë, siguri dhe shkallëzueshmëri.

Argumentim për kapitullin 6 – SHËRBIMI I INSTALIMIT DHE IMPLEMENTIMIT

Specifikimet teknike për instalimin dhe implementimin janë hartuar për të garantuar që projekti të dorëzohet si një zgjidhje **turn-key**, plotësisht funksionale dhe e integruar.

Për këtë arsye kërkohet që operatori ekonomik të kryejë planifikimin, instalimin, konfigurimin, migrimin, testimin, dokumentimin, trajnimin dhe vënien në punë të të gjithë komponentëve të projektit, si dhe të realizojë testet e performancës, Disaster Recovery dhe High Availability përpara dorëzimit përfundimtar.

Argumentim për kapitullin 7 – MIRËMBAJTJA DHE SLA

Specifikimet për mirëmbajtjen dhe Service Level Agreement (SLA) janë hartuar për të garantuar funksionimin e pandërprerë të infrastrukturës pas implementimit.

Kërkesat për kohët maksimale të reagimit sipas niveleve P1–P4, mbështetjen 24/7 për incidentet kritike, përditësimet software/firmware, monitorimin, raportimin dhe eskalimin e incidenteve janë vendosur për të garantuar disponueshmërinë e sistemeve kritike dhe vazhdimësinë e shërbimeve të UKT sh.a.

Përshkrimi i Fazave të Projektit / Mirëmbajtja

Specifikimet teknike për **fazat e projektit dhe shërbimet e mirëmbajtjes** janë hartuar për të garantuar realizimin me sukses të projektit, funksionimin e qëndrueshëm të infrastrukturës së implementuar, si dhe vazhdimësinë e shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit të Autoritetit Kontraktor.

Objekti i kësaj procedure nuk konsiston vetëm në furnizimin me pajisje hardware dhe software, por përfshin projektimin, instalimin, konfigurimin, integrimin, migrimin, testimin, dokumentimin, trajnimin dhe mirëmbajtjen e një infrastrukture të integruar enterprise, e cila përbëhet nga Infrastrukturë Hiperkonvergjente (HCI), sistemi i Backup dhe Disaster Recovery, pajisjet e sigurisë së rrjetit (Firewall), infrastruktura e rrjetit të Data Center-it, si dhe të gjithë komponentët mbështetës të saj.

Duke marrë në konsideratë kompleksitetin teknik dhe rëndësinë e kësaj infrastrukture për funksionimin e sistemeve kritike të UKT sh.a., është e domosdoshme që implementimi të realizohet në faza të mirëpërcaktuara, të cilat përfshijnë planifikimin, implementimin, testimin, migrimin, dokumentimin, trajnimin, pranimin përfundimtar dhe mirëmbajtjen pas implementimit. Kjo metodologji siguron kontroll të plotë të projektit, menaxhim efektiv të risqeve, garantim të cilësisë dhe realizim të të gjitha kërkesave teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Faza e implementimit përfshin instalimin fizik të pajisjeve, konfigurimin e platformave software, integrimin e të gjithë komponentëve të infrastrukturës, migrimin e shërbimeve ekzistuese dhe vënien në funksion të sistemit, duke garantuar që të gjithë komponentët të funksionojnë si një zgjidhje e vetme dhe plotësisht e integruar.

Po kështu, faza e testimit është përcaktuar për të verifikuar performancën, disponueshmërinë e lartë (High Availability), funksionimin e mekanizmave të Backup dhe Disaster Recovery, funksionalitetin e politikave të sigurisë, si dhe përputhshmërinë e zgjidhjes me kërkesat funksionale dhe teknike të Autoritetit Kontraktor, përpara dorëzimit përfundimtar të projektit.

Kërkesa për përgatitjen dhe dorëzimin e dokumentacionit teknik është vendosur për të garantuar që Autoriteti Kontraktor të disponojë dokumentacion të plotë mbi arkitekturën e sistemit, konfigurimet e implementuara, politikat e backup-it dhe replikimit, konfigurimet e sigurisë, si dhe informacionin e nevojshëm për administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës në të ardhmen.

Gjithashtu, kërkesa për zhvillimin e trajnimit praktik (**On-the-Job Training**) është vendosur për të siguruar transferimin e njohurive tek stafi teknik i Autoritetit Kontraktor, me qëllim administrimin, monitorimin dhe mirëmbajtjen efektive të infrastrukturës së implementuar.

Specifikimet që lidhen me mirëmbajtjen dhe **Marrëveshjen e Nivelit të Shërbimit (Service Level Agreement – SLA)** janë përcaktuar për të garantuar funksionimin e pandërprerë, të sigurt dhe të besueshëm të infrastrukturës gjatë periudhës së garancisë. Afatet e reagimit për incidentet sipas niveleve të prioritetit (P1–P4), mbështetja teknike, përditësimet e software-it dhe firmware-it, monitorimi proaktiv, raportimi periodik dhe procedurat e eskalimit janë vendosur për të minimizuar kohën e ndërprerjes së shërbimeve, për të siguruar vazhdimësinë operacionale dhe për të mbrojtur sistemet kritike të Autoritetit Kontraktor.

Për rrjedhojë, njësia e prokurimit vlerëson se këto specifikime teknike janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës, janë të domosdoshme për realizimin me sukses të projektit dhe janë plotësisht proporcionale me kompleksitetin dhe rëndësinë e tij. Këto kërkesa nuk kufizojnë konkurrencën, pasi janë përcaktuar mbi bazën e funksionaliteteve dhe performancave minimale të nevojshme, duke lejuar ofertimin e zgjidhjeve ekuivalente që plotësojnë të njëjtin nivel teknik, funksional dhe cilësor.